



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERET PUBLIKE

Nr. 209/5 prot.

Tiranë, më 12.5.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 657 datë 28.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Periand Teta
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 28.4.2023, është njoftuar vendimi nr. 657, datë 28.4.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Periand Teta, Ndihmësligjor në Gjykatën e Lartë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 657, datë 28.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka ushtruar funksionin e Ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, prej datës \*\*.2.2014 deri në datën \*\*.7.2017, kur është liruar nga detyra me anë të Urdhrit nr. \*\*\*, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë në ILDKPKI, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 84/2016, deklaratën për kontrollin e figurës, në Drejtorinë e

Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 84/2016 dhe formularin e vetëvlerësimit profesional pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në nenin 41 të ligjit nr. 84/2016.

**3.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka vendosur fillimin e hetimit administrativ, sipas procedurave të rivlerësimit për subjektin, z. Teta, dhe bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar deklaratën e pasurisë, pranë ILDKPKI-së, deklaratën për kontrollin e figurës pranë DSIK-së, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016.

**4.** Komisioni, më datë 21.6.2021, ka njoftuar në rrugë elektronike subjektin, z. Periand Teta, për përbërjen e trupës gjyquese, si dhe i ka dërguar pyetësonin standard, për qëllim të procesit të rivlerësimit. Në përgjigje të këtij *email*-i, z. Teta ka deklaruar se nuk ka asnjë shkak papajtueshmërie apo konflikt interesi me trupën gjyquese, si dhe i ka dërguar Komisionit, në rrugë elektronike, përgjigjet e pyetësorit standard dhe dokumentacionin shoqërues.

**5.** Komisioni, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.3.2023, i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku i kanë kërkuar informacion në lidhje me marrëdhëniet e punësimit, kohën, formën dhe largimin nga ushtrimi i funksionit të ndihmësit ligjor, të z. Periand Teta, pranë Gjykatës së Lartë.

**6.** Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.3.2023, i ka përcjellë Komisionit dokumentet: (i) Urdhrin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë nr. 44, datë 3.2.2014, “Për emërimin në detyrë të z. Periand Teta”; (ii) Urdhrin nr. 186, datë 25.7.2017, “Për përfundimin e kontratës së punësimit me afat të z. Periand Teta me Gjykatën e Lartë dhe lirimimin e tij nga detyra e ndihmësit ligjor”; (iii) Kontratën individuale të punës nr. \*\* prot., datë \*\*.2.2014, të punëdhënësit, Gjykatës së Lartë, dhe punëmarrësit, z. Periand Teta; (iv) Shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2017, ku z. Periand Teta kërkon reagimin e Gjykatës së Lartë lidhur me marrëdhëniet e tij të punës.

**7.** Në vijim, Komisioni me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*.3.2023, i është drejtuar Gjykatës së Lartë, ku i kanë kërkuar informacion mbi pagesat e marra nga ndihmësi ligjor P. Teta. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.3.2023, ka informuar se z. Teta ka përfituar të ardhura nga paga *neto* si ndihmësligjor në Gjykatën e Lartë, për periudhën \*\*.2.2014 – \*\*.7.2016, dhe se nga muaji gusht i vitit 2016, nuk ka përfituar më të ardhura nga paga si ndihmësligjor.

**8.** Komisioni, në datën 18.4.2023, me anë të postës elektronike ka njoftuar z. Teta, lidhur me: (i) me konkluzionin e arritur nga ana e trupit gjyqësor mbi statusin ligjor të tij; (ii) korrespondencën që ka shërbyer për këtë konkluzion në referencë të nenit 22/b të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me dërgimin nëpërmjet *email*-it të skanimit të të gjithë komunikimit me institucionet gjatë kësaj periudhe; (iii) me të drejtën e tij për të sjellë shpjegime lidhur me konkluzionin e Komisionit dhe të drejtën e tij për t’u shprehur në seancë dëgjimore publike. Në përgjigje, z. Teta ka njoftuar Komisionin se nuk do të paraqiste parashtrësia lidhur me konkluzionin e arritur nga trupi gjyqësor dhe nuk dëshironte të paraqitej në seancën publike.

9. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të provave dhe fakteve të mbledhura, mbështetur në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016, dispozitat kalimtare të ligjit nr. 96/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, ka vendosur:

- (i) Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për z. Periand Teta;
- (ii) Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016;
- (iii) Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

10. Në vendimin përkatës, rezulton se Komisioni arsyeton në dy drejtime, duke vlerësuar situatën ligjore nëse z. Teta është në kushtet për t’u konsideruar subjekt rivlerësi sipas nenit 179/b, pika 4, paragrafi i parë<sup>1</sup>, dhe së dyti, nëse ai (nisur nga kërkesa e tij drejtuar ILDKPKI-së), është në kushtet për t’u konsideruar si ish-këshilltar, sipas paragrafit të dytë<sup>2</sup> të së njëjtës dispozitë kushtetuese.

11. Komisioni ka arritur në përfundimin e parë, se z. Periand Teta nuk bën pjesë në kategorinë e subjekteve të rivlerësimit *ex officio*, duke arsyetuar, ndër të tjera, se:

Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se z. Teta ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë dhe ka përfituar të ardhura nga kjo detyrë prej datës \*\*.2.2014<sup>3</sup> deri më \*\*.7.2016. Duke filluar nga muaji gusht i vitit 2016, ai nuk ka përfituar të ardhura nga paga si ndihmësligjor. Komisioni ka vlerësuar se z. Teta nuk është subjekt rivlerësi i ligjit nr. 84/2016, pasi në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ai ishte i pezulluar nga detyra dhe nuk e ushtronte efektivisht funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Në këtë përfundim, Komisioni i ka dhënë rëndësi faktit të pezullimit nga detyra, duke vlerësuar se në datën \*\*.7.2016, kontrata e tij e punës konsiderohej e zgjidhur, pasi kishin ndryshuar disa nga elementet thelbësore të kësaj kontrate, siç është dhe paga, të cilën nuk e përfitonte më. Në këtë kontekst, Komisioni ka vlerësuar edhe shkresën me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2017, të z. Teta, me anë të së cilës i është drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë, duke kërkuar informacion mbi statusin dhe vijimësinë e marrëdhënieve të tij të punës, ku ndër të tjera, ka kërkuar se: “Jam pezulluar nga data \*\*.7.2016, por nga ana e institucionit të Gjykatës së Lartë nuk ka asnjë vendimmarrje në lidhje me vijueshmërinë e marrëdhënies së punës. Ju sjell në vëmendje se duhet të shmangen veprimet, të cilat cenojnë të drejtat e punëmarrësit, si dhe veprimet e

<sup>1</sup> Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.

<sup>2</sup> Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohet me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.

<sup>3</sup> Urdhri nr. \*\*, datë \*\*.2.2014, “Për emërim në detyrë”, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

*punëdhënësit duhet të jenë të bazuara në ligj për të mos tejkaluar të drejtën e tyre gjatë ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve gjatë marrëdhënies së punës”.*

Në përgjigje të kësaj shkrese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet urdhrit nr. \*\*\*, datë \*\*7.2017, ka njoftuar z. Teta mbi përfundimin e kontratës së punësimit me Gjykatën e Lartë, dhe lirim të tij nga detyra e ndihmësit ligjor, urdhër i cili ka hyrë në fuqi menjëherë. Komisioni ka vlerësuar se efektet financiare të këtij urdhri datonin nga data \*\*7.2016, kohë kur ai nuk trajtohej me pagë si ndihmësligjor.

Komisioni ka konstatuar se z. Teta ka dhënë pëlqimin në mënyrë të heshtur për ndërprerjen e kontratës së tij të punës në funksionin e ndihmësit ligjor, duke mos e ankimuar atë gjyqësisht. Mungesa e kundërshtimit në rrugë gjyqësore të veprimeve të punëdhënësit, të cilat cenonin të drejtat e punëmarrësit, është konsideruar nga trupi gjykues i Komisionit si shprehje e pëlqimit të heshtur dhe dakordësim i tij lidhur me këtë procedurë.

**12.** Nisur nga fakti i rezultuar se z. Teta me anë të kërkesës me nr. \*\*\* prot., datë \*\*8.2017, drejtuar ILDKPKI-së, ka kërkuar për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit vullnetarisht si ish-këshilltar, pasi plotësonte kriterin trevjeçar të punësimit si ndihmësligjor, Komisioni ka arritur në përfundimin e dytë, se z. Teta nuk bën pjesë në këtë kategori subjektsh rivlerësimi, duke arsyetuar, ndër të tjera, se:

Në përputhje me nenin 179/b të pikës 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës, procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret *sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet*. Terminologjia “ish” nënkupton subjektet që me hyrjen e ndryshimeve kushtetuese në fuqi cilësoheshin si ish-gjyqtarë, ish-prokurorë dhe ish-këshilltarë, që kishin punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet. Në vlerësim të kësaj dispozite, z. Teta nuk gëzon statusin e ish-këshilltarit ligjor, për sa kohë nuk provohet se ka punuar në këtë pozicion për 3 vjet, pasi periudha e punësimit të tij pranë Gjykatës së Lartë ka qenë efektivisht nga data \*\*2.2014 deri më \*\*7.2016, si dhe nga gushti i vitit 2016, nuk ka përfituar më të ardhura nga paga si ndihmësligjor.

**13.** Nisur nga sa më sipër, Komisioni, përfundimisht, ka vlerësuar se z. Teta nuk bën pjesë as në kategorinë e subjekteve të rivlerësimit *ex officio* dhe as nuk mund të trajtohet si ish-këshilltar ligjor, duke arritur në konkluzionin se procesi i rivlerësimit duhet ndërprerë pa një vendim përfundimtar, sipas përcaktimeve të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: *“Procedimi administrativ përfundon kur organi administrativ kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar zbulon se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur”*.

**14.** Lidhur me zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në orientimin e dhënë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin (JR) nr. 17/2019, Komisioni ka vlerësuar se jemi para rasteve të parashikuara në nenin 89 të K. Pr. Administrative, sipas të cilave procedura administrative mund të mbyllet pa i dhënë mundësinë për t’u dëgjuar, për sa kohë vetë subjekti kishte shprehur vullnetin e tij se nuk do të paraqiste parashitë, si dhe nuk do të paraqitej në seancën publike.

### III. Shkaqet e ankimit

15. Komisioneri Publik, në vlerësim të rrethanave dhe fakteve të administruara nga Komisioni, për subjektin e rivlerësimit z. Teta, në konsideratë të qëllimit të përcaktuar nga neni 179/b i Kushtetutës dhe jurisprudencës së Kolegjit<sup>4</sup>, çmon se vendimi i Komisionit nuk është i drejtë dhe i bazuar, pasi arsyetimi i fakteve dhe rrethanave ligjore është jo i qartë dhe i pamjaftueshëm për aplikimin e nenit 95, të K. Pr. Administrative, e për rrjedhojë, duke shmangur kështu zbatim e nenit G të aneksit të Kushtetutës.

16. Komisioni, në raport me ecurinë e mëtejshme të procesit të rivlerësimit, në rastin konkret ka argumentuar në mënyrë jo të qartë statusin që gëzon subjekti z. Teta, duke mos identifikuar drejtë shkakun ligjor determinant për përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar. Nisur nga arsyetimi i vendimit për cilësimin e statusit ligjor të subjektit, Komisioni, fillimisht, ka arsyetuar nën regjimin e nenit 179/b, pika 4, fjalia e parë, *këshilltarët ligjorë* të Gjykatës së Lartë, dhe në vijim për një kategorinë tjetër, atë *ish-këshilltarit*, status i cili gjen një rregullim tërësisht të ndryshëm ligjor, referuar rregullimeve të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht nenet 31, pika 3, 35, pika 3 dhe 41, pika 2, të këtij ligji, pra respektimit të rrugës procedurale dhe afatit 3-mujor nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

17. Në rastin konkret, në vlerësimin e Komisionerit Publik, merr rëndësi fakti që subjekti në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, ligjërisht ushtronte funksionin e ndihmësit ligjor në organikën e Gjykatës së Lartë, duke plotësuar në këtë mënyrë përcaktimin e pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Vetë subjekti e ka konsideruar dhe trajtuar veten në të njëjtën mënyrë, për sa kohë që, në janar të vitit 2017, ka plotësuar deklaratat sipas shtojcave të ligjit nr. 84/2016, veprim i cili është përcaktuar të kryhet prej subjekteve të rivlerësimit.

18. Komisioneri Publik e vlerëson jo të bazuar arsyetimin e Komisionit se z. Teta nuk gëzonte statusin e subjektit të rivlerësimit, pasi në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ai ishte i pezulluar nga funksioni i ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, dhe nuk e ushtronte efektivisht detyrën, dhe as paguhej për këtë detyrë. Në këtë vlerësim, duket se Komisioni merr atributet e një juridiksioni tjetër, duke arsyetuar mbi elementet kontraktuale dhe efekteve ligjore të tyre në marrëdhënien e punës, duke barazuar periudhën e punësimit të subjektit pranë Gjykatës së Lartë (\*\*.2.2014 deri në \*\*.7.2017), me periudhën që ka përfituar të ardhura financiare nga detyra (\*\*.2.2014 deri në \*\*.7.2016). Në vlerësimin e Komisionerit Publik, këto dy momente nuk kanë asnjë arsye ligjore për t'u barazuar, pasi rëndësi ka vetëm statusi ligjor që gjendet subjekti në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe vullneti apo qëndrimi i subjektit në raport me ecurinë e procesit të rivlerësimit, si dhe vlerësimi i ekzistencës së kushteve ligjore për ndërprerjen e këtij procesi pa një vendim përfundimtar. Në këtë kontekst, fakti i pezullimit nga detyra nuk është një rrethanë relevante dhe e aftë të ndikojë në vijimin apo jo të procesit të rivlerësimit, për sa kohë që ajo është një rrethanë e ndryshueshme, e papërcaktuar në mënyrë përfundimtare dhe me efekte jo shuese për të drejtat dhe statusin e subjektit.

<sup>4</sup> Shihni vendimin e KPA-së (JR) nr.1/2018; nr. 17/2019 dhe nr. 21/2022.

**19.** Nisur nga sa më sipër, vlerësojmë se vendimi i Komisionit në tërësinë e tij është i paqartë dhe jo i arsyetuar në mënyrë bindëse në drejtim të shkakut ligjor të përmbylljes së procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin z. Teta, në kushtet e nenit 95 të K. Pr. Administrative, duke justifikuar kështu mosaplikimin e nenit G, të aneksit të Kushtetutës, sikundër jurisprudenca gjyqësore e Kolegjit përcakton për këto raste.

**20.** Lidhur me qartësinë e arsytimit të vendimit, në referencë të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit ka mbajtur qëndrimin se: *“Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë ... Dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhje ndërmjet disa mundësive...”* (Vendimi nr. 11/2008).

**21.** Në zbatim të orientimit të dhënë nga KPA me vendimin e saj nr. 1/2018, Komisioni ka kërkuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor informacion mbi shprehjen e vullnetit të subjektit për dorëheqje nga funksioni i ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Nga aktet e përcjella nga KLGJ, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë \*\*.3.2023, nuk konfirmohet një kërkesë me shkrim për dorëheqje nga funksioni i ndihmësit ligjor, por një shkresë e subjektit, datë \*\*.7.2017, drejtuar punëdhënësit mbi vijueshmërinë e marrëdhënieve të tij të punës. Në vijim të saj ka dalë urdhri i Kryetarit të Gjykatës së Lartë nr.\*\*\*, në datën \*\*.7.2017, për përfundimin e kontratës së punës të z. Periand Teta dhe lirimin e tij nga detyra, në këtë datë, pa efekte të mëparshme.

**22.** Pavarësisht të drejtës së tij ligjore, z. Teta nuk e ka ankimuar këtë vendimmarrje në Gjykatë, por ka paraqitur në ILDKPKI kërkesën e tij nr. \*\*\* prot., datë \*\*.8.2017, për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit.

**23.** Gjithashtu, Komisioneri Publik, nga burimet e hapura, të aksesueshme lehtësisht prej tij, që kanë statusin e fakteve të njohura botërisht, sipas përcaktimit të nenit 13 të Kodit të Procedurës Civile, i rezulton se pas largimit nga detyra në Gjykatën e Lartë, subjekti<sup>5</sup>, z. Teta, është emëruar në pozicionin e ri të Inspektorit pranë Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor, si dhe ka drejtuar Drejtorinë e Hartimit të Akteve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit, në Ministrinë e Drejtësisë, emërim që duket se ka qenë me pëlqimin e tij.

**24.** Komisioneri Publik vlerëson se një vendim i ardhur si rezultat i një arsytimi të plotë dhe të kuptueshëm gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve, në raport edhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit për rastet e ndërprerjes së procesit, kur subjekti i rivlerësimit largohet nga detyra.

**25.** Në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) nr. 21, datë 17.6.2022, për subjektin \*\*\*.\*\*\*, KPA ka vlerësuar se: *“Komisioni ka aplikuar me të drejtë dispozitat e posaçme që rregullojnë dhe trajtojnë dorëheqjen sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 56 të ligjit nr. 84/2016 dhe jo dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative, të cilat mund të thirren për zbatim vetëm në mungesë të rregullimit të posaçëm, sipas përcaktimit të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti rezulton të ketë ndërprerë me vullnet marrëdhënien e punës që i jepte atij statusin e subjektit të rivlerësimit, fituar me hyrjen në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke u gjendur në këtë mënyrë në kushtet e e dorëheqjes sipas parashikimit të dispozitave të cituara më lart.*

---

<sup>5</sup> Shihni : <https://ild.al/sq/zyra-e-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë/stafi-yne/periand-teta/>

26. Po në këtë vendim, KPA ka argumentuar se: “Së pari ...vullneti i subjekteve për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit... ndërpret detyrën funksionale, që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit ex-officio, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës.

Së dyti, Kolegji vlerëson se humbja e statusit të subjektit të rivlerësimit me vullnetin e tij, pavarësisht motiveve dhe qëllimeve që e shtyjnë atë drejt këtij akti, e bën të pamundur vijimin e këtij procesi të rivlerësimit edhe në kushtet kur subjekti kërkon t'i nënshtrohet atij, duke qenë se ndërprerja e procesit dhe vendosja e ndalimit të parashikuar nga neni G i aneksit të Kushtetutës konsiderohet si alternativë imperative dhe e vetme për zbatim në rastet e humbjes së statusit për shkak të dorëheqjes”.

27. Sa më sipër, në analizë të fakteve dhe provave, kuadrit ligjor dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, subjekti duket se është në kushtet e dorëheqjes nga detyra e ndihmësit ligjor, duke dhënë një pëlqim të heshtur për ushtrimin e detyrës së re. Edhe pse shprehja e vullnetit për të larguar nga marrëdhënia e punës si ndihmësligjor në Gjykatën e Lartë nuk rezulton të jetë bërë me një kërkesë formale nga subjekti, mungesa e kundërshtimit të këtij vendimi, marrë në konsideratë së bashku me faktin që, menjëherë pas largimit nga detyra në Gjykatën e Lartë, me pëlqimin e tij ka vijuar në pozicionin e ri në Ministrinë e Drejtësisë, duket se është shprehje e dakordësisë/pëlqimit të heshtur nga ana e subjektit të rivlerësimit.

28. Komisioneri Publik vlerëson se në rastin konkret, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, nuk jemi në kushtet që kanë çuar Komisionin në përfundimin e këtij procedimi pa një vendim përfundimtar, por, subjekti ndodhet në kushtet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës.

29. Për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të aneksit të Kushtetutës do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj, duke i kufizuar të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

30. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin;

31. Në kushtet kur vetë Komisioni më parë në kohë nga marrja e vendimit konkret nr. 645/2023, dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit, në dy raste të tjera të vendimit nr. 17/2019 dhe 21/2022, ka parashikuar në pjesën urdhëruese të vendimit aplikimin e plotë të nenit G, të aneksit të Kushtetutës;

**32.** Referuar nenit F dhe G të aneksit të Kushtetutës, jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, kërkohet që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66/1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 657, datë 28.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**